



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 03-13

10.01.2023

Shkup

Në Bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21) dhe nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, nenet 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.172/14), dhe në lidhje me nenin 2 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.96/19) dhe neni 3 i Kodit Penal („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.37/96, 80/99, 48/01, 4/02, 16/02, 43/03, 19/04, 40/04, 81/05, 50/06, 60/06, 73/06, 87/07, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 143/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17, 170/17, 248/18), pika 6 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) me nr.ark.01-6039/1 datë 20.10.2015 dhe Konkluzionin me nr.ark.02-39/4 datë 10.01.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 1-rë mbajtur më 9.1.2023, miratoi si vijon

Aktvendim
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare me veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP, për shkeljen e kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe të neneve 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRPMM), në mënyrë që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, transmetuar më 4 nëntor 2022, në filmin artistik „Dobar den da se umre mashki“ është transmetuar me sinjalizim të gabuar (8+) dhe në kohë të papërshtatshme gjatë ditës dhe natës, ndërsa filmi artistik „Devojkata od vozot“, është transmetuar me shenjën e gabuar sinjalizuese (8+).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.10-4439/1 datë 29.11.2022, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunishtë SHPKNJP, që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe RRPMM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij konsiderohet dita e vërtetimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente të kryej mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar(cekur) dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale nuk duhet të transmetojnë programe që mund seriozisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të personave të mitur, në veçanti programe me përmbajtje pornografike ose dhunë të panevojshme. Ndalesa nga paragrafi (1) i këtij neni i referohet dhe programeve të tjera që mundësojnë dëmtimin fizik, psiqik dhe moral të personave të mitur, por lejohet vetëm në rastet kur është i sigurt transmetimi i tyre ose repriza në periudha të caktuara kohore dhe/ose nëpërmjet aplikimit të masave të caktuara teknike, ku personat e mitur gjatë kohës së transmetimit ose ritransmetimit nuk do të mund t'i dëgjojnë ose t'i ndjekin këto programe. Nëse programe të tilla transmetohen ose ritransmetohen në formë jo të koduar, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale obligohen para transmetimit të tyre të sigurojnë paraprakisht sinjal akustik dhe mundësi identifikimi me ndihmën e shenjave vizuale gjatë kohëzgjatjes së tyre. (neni 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV).

Në nenin 16 të RRPMM parashikon se në varësi të përbërës së pritshmërisë të audiencës, kategoritë e programeve mund të transmetohen në këto periudha kohore: programet e kategorisë së parë dhe të dytë transmetohen gjatë gjithë ditës dhe natës; kategoria e tretë transmetohet në periudhën nga ora 20:00 deri në orën 05:00; kategoria e katërt transmetohet në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00 dhe kategoria e pestë transmetohet në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 05:00.

Në nenin 17 paragrafi (1) pika 2 të RRPMM parasheh se në kategorinë e dytë janë klasifikuar programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 8 vjet, ku dhe rekomandohet kontrolli nga prindi ose kujdestari. Mund të transmetohet gjatë gjithë ditës dhe natës, me rekomandim të kontrollohen nga prindi ose kujdestari. Është e mundur të trajtohen tema më serioze: sjellje devijuese, dhunë familjare, racizëm dhe të ngajshme, megjithatë programet në asnjë rast nuk duhet të inkurajojnë, dhe as të përfshijnë në vetvete ndonjë afirmim të sjelljes devijuese ose sjellje që është fyese për dinjitetin njerëzor. Nuk lejohet përdorimi i mbitheksuar i fjalëve të turpshme (vullgare). Neutral, paraqitje natyrale e trupit lakuriq njerëzor është e lejuar, megjithatë pa çfarë do lloji qoftë të konteskti seksual. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me erotikë duhet të jenë jashtëzakonisht të rralla dhe mjaft të patheksuara, diskrete dhe pa aludime vulgare. Është e lejuar shfaqja e dhunës e moderuar, por pa detaje të mizoris, e justifikuar në komplotin e skenarit, por pa u theksuar prezenca reale e armës ose e teknikave të rrezikshme për llogaritje ndërpersonale.

Në kuadër të kompetenceve Ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 29 nëntor 2022, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP, transmetuar më 4 nëntor 2022, në nivel lokal, nga ku u konstatua shkelje e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të neneve 16 dhe 17 të RRPMM. Nga mbikëqyrja e rregullt programore u konstatua se më 4 nëntor 2022, në kuadër të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP, filmin artistik „Dobar den da se umre mashki“ është transmetuar me sinjalizim të gabuar (8+) dhe në kohë të papërshtatshme gjatë ditës dhe natës, ndërsa filmi artistik „Devojkata od vozot“, është transmetuar me sinjalizim paralajmërues të gabuar por në periudhë të përshtatshme kohore. Filmat artistik: „Dobar den da se umre mashki“ dhe „Devojkata od vozot“ janë shënuar si programe të kategorisë së dytë (8+), që nuk rekomandohen për fëmijët e moshës 8 vjeçare dhe është i domosdoshëm kontrolli nga prindi ose kujdestari. Sipas kriterëve të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur, këto programe duhej të shënoheshin si programe të kategorisë së katërt (16+), që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 16 vjeç, ku rekomandohet kontrolli nga prindi ose kujdestari, dhe mund të transmetohen në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.10-4439/1 datë 29.11.2022, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP, më 30.11.2022, ka dërguar Shkresë me Nr.yne.ark.10-4439/2 datë 30.11.2022, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.10-4439/1 datë 29.11.2022, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe të RRPMM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e radiodifuzerit më datë 3.12.2022. Në afatin e paraparë, Shoqëria Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 9.1.2023, e shqyrtoi lëndën

Raport me shkrim dhe konstatoi se Shoqërisë Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më lartë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të LSHMAAV dhe neni 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16 dhe 17 të RRPMM, dhe në lidhje me nenin 2 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje dhe neni 3 i Kodit Penal, pika 6 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) me nr.ark.01-6039/1 datë 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyejen e kryer programore me nr.ark.10-4439/1 datë 29.11.2022 dhe Konkluzionin me nr.ark.02-39/4 datë 10.1.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe të RRPMM, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 9.1.2023, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmërohet Shoqëria Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP, dhe urdhërohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe RRPMM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyeje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

Bazuar në sa më lartë, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me nr.ark.10-4439/1 datë 29.11.2022.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Pkundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

Dorëzuar deri tek:

- Shoqërisë Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP;
- Drejtuesit të Shoqërisë Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP
- Personit përgjegjës të programit në Shoqërinë Tregtare për veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna Llabunisht SHPKNJP;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike;
- Sektorit për çështje programore; dhe
- Personat e emëruar në Agjencion për udhëheqjen e regjistrit PA1.